

“ SFIDAT E ARSIMIT NË MITROVICË GJATË KOHËS SË OKUPIMIT (1990 – 1999)”

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I SOCIOLOGJISË

NGA

QËNDRESA BUCINCA – RAMA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

PRISHTINË

PRILL, 2023

REZYME

“ SFIDAT E ARSIMIT NË MITROVICË GJATË KOHËS SË OKUPIMIT (1990 – 1999) “

MENTORI :

Prof. Ass. Dr. Fadil Maloku

Objektivi kryesor i kësaj teme të masterit është të evidentojë dhe të paraqes një panoramë të plotë për diskriminimin që i është bërë arsimit në Mitrovicë në vitet 1990-1999.

Tema në fjalë paraqet fillet e përpjekjes serbe pas suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe kthimit të saj nën masat e dhunshme, duke i serbizuar të gjitha institucionet e posaçërisht duke tentuar që mësimin shqip t’u kontrolloj përmes aplikimit të dhunshëm të plan-programeve serbe në shkollat fillore në komunën e Mitrovicës.

Në këtë punim kam paraqitur disa raste të aplikimit të formave të ndryshme të diskriminimit, si: ndarjen fizike të shkollave, pengimin e fillimit të procesit mësimor, tendencën për aplikim të dhunshëm të planprogramit serb, dhunës fizike dhe psiqike në shkolla të nxënësve dhe mësimdhënësve të tyre në komunën e Mitrovicës, helmimet e nxënësve etj. Poashtu në këtë punim kam paraqitur vendosmërinë e përpjekjeve të mësimdhënësve, nxënësve e udhëheqësve për zhvillimin e mësimin me planprogram shqip, vendosmërinë e punës në zhvillimin e arsimit shqip përgjatë një dekade si dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare përkundër përpjekjeve të dhunshme kundër zhvillimit të saj.

Për nga struktura, e kam ndarë punimin në pesë pjesë apo kapituj.

Në strukturën e punimit kam paraqitur pjesën hyrëse dhe historikun e zhvillimit të arsimit shqip në komunën e Mitrovicës gjatë periudhës 1990 - 1999. Punimi në strukturën e tij përmban gjithashtu edhe pesë kapituj, duke përfshirë këtu edhe rezultatet e hulumtimit. Të dhënat në këtë hulumtim janë mbledhur me anë të pyetësorit, i cili përbëhet nga 13 pyetje, prej të cilave 3 janë pyetje demografike dhe 10 pyetje në lidhje me temën e hulumtimit. Të dhënat janë realizuar me programin statistikor të shkencave shoqërore SPSS 20, duke përdorur analizat përshkruese dhe analizat e korrelacionit. Po ashtu, kemi zhvilluar intervista me mësimdhënës, nxënës dhe drejtorë të viteve 90-ta.

Kapitulli i parë është hyrja e punimit duke përfshirë diskutim mbi rolin dhe rëndësinë e shkollimit dhe arsimit dhe gjithashtu janë te diskutuara edhe qëllimet dhe hipotezat e punimit. Arsimi shqip gjatë viteve 1990 – 1999 është kapitulli i dytë. Në këtë kapitull kam paraqitur ndalimin e mësimi në gjuhën shqipe në Kosovë dhe krijimin e sistemit paralel në Kosovë gjatë viteve 1990 – 1999. Në vitin 1991, Serbia ndër morri një vendim unik në botë! Në këtë vit gjatë muajve shtator dhe tetor mësimi në gjuhën shqipe është ndaluar në të gjitha nivelet. Millosheviqi, kishte vendosur t'i jetësojë të gjitha projektet e shumta serbe me të cilat parashihej shfarosja graduale e popullit shqiptar nga Kosova.

Mirëpo, ndërkohë, duke parë qëllimet e Serbisë, Drejtori i Entit për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit të Kosovës, ende sa ishte duke ushtruar detyrën në lokalet zyrtare vendos të krijojë një strategji veprimi në kushte dhe në rrethana të reja të krijuara. I vetëdijshëm se do të mbyllen të gjitha institucionet e arsimit kishte vendosur që të krijojë struktura të reja, të cilat përkohësisht mund të vepronin dhe njëherësh të zëvendësonin organet e suprimuara. Gjatë konsultimeve u vendos të formohet Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë “Naim Frashëri” LASH. Gjatë këtij kapitulli është përmendur edhe studiuesja Denisa Kostovicova për faktin se ishte në mesin e studiuesve që i kushtoi rëndësi organizimit të mësimi në librin e saj “ Kosovo – The pilitics of identity and space “. Në studimin e saj thekson që rruga e sistemit arsimor dy kombesh të Kosovës në konfrontimin serbo-shqiptar rreth statusit kushtetues të Kosovës drejtpërdrejt ka pasur të bëjë me juridiksionin mbi sistemin arsimor në Kosovë.

Kapitulli i tretë flet për sfidat e arsimit në Mitrovicë gjatë kohës së okupimit (1990 – 1999)
Gjatë këtij kapitulli kam diskutuar për sfidat nëpër të cilat kaluan mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë asaj periudhe. Viti shkollor 1991/1992 nuk filloi në kushtet e parapara. Më 10 Shtator 1991 Sindikata e Arsimit e Kosovë dhe Lidhja e arsimtarëve Shqiptarë “ Naim Frashëri “ organizuan një protestë në Prishtinë. Në këtë protestë morrën pjesë mësimdhënës nga e gjithë Kosova e poashtu edhe nga Mitrovica. Policia serbe i maltretoi shumë pjesëmarrësit e protestës duke marrë edhe lëndime të rënda tupore disa nga ta. Në këto rrethana viti shkollor nuk filloi në kohën e duhur sidomos për shkollat e mesme.

Ishte data 20 Janar kur planifikohej fillimi i vitit shkollor sipas Ministrisë së Arsimit por në kushte jo normale pasi mësimi do të zhvillohej kryesisht në shtëpi-shkolla të cilat ishin ndihmë nga shumë qytetar dhe pjesa tjetër nëpër shkolla fillore. Në Mitrovicë, në prag të ndërmarrjes së masave të dhunshme, kanë qenë 32 shkolla fillore dhe 5 shkolla të mesme. Prej tyre kanë qenë 19 shkolla të pastra shqipe, tri serbe të pastra, 10 shkolla të përziera, një shkollë e lartë dhe Fakulteti Xehetaro-Metalurgjik. Por, një kontribut të veçantë, për zhvillimin e procesit arsimor në Mitrovicë ashtu si në tërë Kosovën, pa dyshim kanë dhënë bashkatdhetarët tanë.

Hulumtimi “*Sfidat e arsimit në Mitrovicë gjatë kohës së okupimit (1990 - 1999)*” ngërthen një problem të rëndësishëm, që ka të bëjë me zhvillimin e procesit edukativo-arsimor në shkollat e Mitrovicës dhe në rrethinën e saj gjatë viteve 1990-1999. Të dhënat në këtë hulumtim janë mbledhur me anë të pyetësorit, i cili përbëhet nga 13 pyetje, prej të cilave 3 janë pyetje demografike dhe 10 pyetje në lidhje me temën e hulumtimit. Të dhënat janë realizuar me programin statistikor të shkencave shoqërore SPSS 20, duke përdorur analizat përshkruese dhe analizat e korrelacionit. Po ashtu, kemi zhvilluar intervista me mësimdhënës, nxënës dhe drejtorë të viteve 90-ta. Nga ky punim dhe pas perfundimit të hulumtimit u pa se është e nevojshme edhe një hulumtim në të ardhmen për evidentimin e sfidave të arsimit në komunën e Mitrovicës në vitet e para të pasluftës.

